FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

www.qbz.gov.al

Nr. 22 — 4 mars — 2013

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr. 104, datë 13.2.2013	Për përcaktimin e masës së financimit, nga buxheti i vitit 2013, për bashkësitë fetare tradicionale që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave……	863
Vendim i KM nr. 107, datë 13.2.2013	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2013, miratuar për Ministrinë e Punëve të Jashtme, për pagesën e kontributeve financiare të NATO-s për selinë e re, për vitin 2012……	864
Vendim i KM nr. 108, datë 13.2.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 37, datë 28.1.2002 të Këshillit të Ministrave "Për organizimin dhe funksionimin e repartit të Inspektim-Shpëtim-Minierave", të ndryshuar……	865
Vendim i KM nr. 109, datë 13.2.2013	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Dobrenjë-Tomorricë" dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë……	866
Vendim i KM nr. 110, datë 13.2.2013	Për miratimin e rialokimit të fondeve sipas marrëveshjes së huas dhe programit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave, e Fondit Shqiptar për Zhvillim dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit "Fondi i investimeve sociale IV"……	867
Vendim i KM nr. 113, datë 13.2.2013	Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Konispol të qarkut të Vlorës ……	869
Vendim i KM nr. 114, datë 13.2.2013	Për miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Mamurras të qarkut të Lezhës……	870

Vendim i KM nr. 115, datë 13.2.2013	Për disa ndryshime në vendimin nr. 167, datë 10.3.2010 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Kukës të qarkut të Kukësit"	871
Vendim i KM nr. 116, datë 13.2.2013	Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të disa mjediseve, magazinë, garazh dhe lavanteri e infektivit, në Spitalin Rajonal Elbasan, nga Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Arsimit dhe Shkencës……	871
Vendim i KM nr. 118, datë 13.2.2013	Për një ndryshim në vendimin nr. 109, datë 15.2.2012 të Këshillit të Ministrave "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Brendshme dhe te Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, për Drejtorinë Rrugore Shkodër, të disa objekteve e të truallit funksional, pjesë të pronës nr. 426, me emërtim "Shtabi i Brigadës së Artilerisë", me vendndodhjen në Rrenc, Shkodër, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar"…….	874
Kërkesë e MPPT nr. 293/7, datë 15.2.2013	Për shpronësimin, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë - Elbasan (toka dhe objekte)……	877
	Vendim (i shkurtuar) për shpalljen të zhdukur të shtetases Eda Hasani……	888
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetases Elida Balliu……	888
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur, të shtetasit Haki Klari……	888

VENDIM
Nr. 104, datë 13.2.2013

PËR PËRCAKTIMIN E MASËS SË FINANCIMIT, NGA BUXHETI I VITIT 2013, PËR BASHKËSITË FETARE TRADICIONALE QË KANË NËNSHKRUAR MARRËVESHJE ME KËSHILLIN E MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 4 e 6 të ligjit nr. 10 140, datë 15.5.2009 "Për financimin nga Buxheti i Shtetit të bashkësive fetare që kanë nënshkruar marrëveshje me Këshillin e Ministrave", të nenit 5 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 "Për buxhetin e vitit 2013", me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masa e financimit, prej 105 162 000 (njëqind e pesë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë) lekësh, nga buxheti i vitit 2013, i miratuar për të mbështetur bashkësitë fetare, të përdoret sipas ndarjes së mëposhtme:

a) Komuniteti Mysliman i Shqipërisë përfiton shumën 30 492 000 (tridhjetë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë) lekë, të ndarë përkatësisht:

i) 11 340 000 (njëmbëdhjetë milionë e treqind e dyzet mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 90 punonjës të administratës;

ii) 19 152 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 152 punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

b) Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë përfiton shumën 24 948 000 (njëzet e katër milionë e nëntëqind e dyzet e tetë mijë) lekë, të ndarë përkatësisht:

i) 19 908 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e nëntëqind e tetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 158 punonjës të administratës;

ii) 5 040 000 (pesë milionë e dyzet mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 40 punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

c) Kisha Katolike në Shqipëri përfiton shumën 24 948 000 (njëzet e katër milionë e nëntëqind e dyzet e tetë mijë) lekë, të ndarë përkatësisht:

i) 5 670 000 (pesë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 45 punonjës të administratës;

ii) 19 278 000 (nëntëmbëdhjetë milionë e dyqind e shtatëdhjetë e tetë mijë) lekë, për financimin me gjysmën e pagës minimale buxhetore për 153 punonjës të institucioneve të arsimit parashkollor, parauniversitar dhe universitar.

ç) Kryegjyshata Botërore Bektashiane përfiton shumën 24 774 000 (njëzet e katër milionë e shtatëqind e shtatëdhjetë e katër mijë) lekë, të ndarë përkatësisht:

i) 3 528 000 (tre milionë e pesëqind e njëzet e tetë mijë) lekë, për financimin deri në gjysmën e pagës minimale buxhetore për 28 punonjës të administratës;

ii) 14 246 000 (katërmbëdhjetë milionë e dyqind e dyzet e gjashtë mijë) lekë, për ndërtimin e Selisë së Shenjtë të Kryegjyshatës Botërore Bektashiane (Odeonit);

iii) 7 000 000 (shtatë milionë) lekë, për shkak të pozitës së veçantë si Kryegjyshatë Botërore, me qendër në Tiranë dhe të shtrirjes së veprimtarisë së saj jashtë vendit, që do të përdoret për të mbuluar plotësisht ose pjesërisht kërkesë-preventivat e paraqitura prej saj, në kërkesën e vitit 2013, sipas dokumentacionit financiar të paraqitur për kryerjen e veprimtarive të parashtruara.

2. Kalimi i fondit të bëhet brenda tremujorit të parë të vitit 2013.

3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Financave dhe Komiteti Shtetëror për Kultet për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 107, datë 13.2.2013

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2013, MIRATUAR PËR MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME, PËR PAGESËN E KONTRIBUTEVE FINANCIARE TË NATO-S PËR SELINË E RE, PËR VITIN 2012

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ligjit nr. 10 100, datë 26.3.2009 "Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në traktatin e Atlantikut të Veriut" dhe të nenit 13 të ligjit nr. 119/2012, datë 17.12.2012 "Për buxhetin e vitit 2013", me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Punëve të Jashtme, në buxhetin e miratuar për vitin 2013, në programin 01120 "Mbështetje diplomatike jashtë shtetit", t'i shtohen fondet për pagesën e kontributeve financiare të fondeve të përbashkëta të NATO-s, respektivisht në shumat, si më poshtë vijon:

a) Për "Fondin e përbashkët", për vitin 2012, për ndërtesën e re të selisë së NATO-s, në vlerën 100 415 (njëqind mijë e katërqind e pesëmbëdhjetë) euro, e barasvlershme me vlerën në lekë.

b) Për "Fondin kombëtar", për vitin 2012, për ndërtesën e re të selisë së NATO-s, në vlerën 418 943 (katërqind e tetëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e dyzet e tre) euro, e barasvlershme me vlerën në lekë.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 108, datë 13.2.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 37, DATË 28.1.2002 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E REPARTIT TË INSPEKTIM-SHPËTIM-MINIERAVE", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 14 të ligjit nr. 8741, datë 15.2.2001 "Për sigurinë në punë në veprimtarinë minerare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 10 e vendimit nr. 37, datë 28.2.2002 të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

"10. Organika e Repartit të Inspektim-Shpëtim-Minierave (RISHM) të jetë sipas skemës nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.".

2. Vendimi nr. 760, datë 8.7.2009 i Këshillit të Ministrave, shfuqizohet.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Skema nr. 1

ORGANIKA E REPARTIT TË INSPEKTIM-SHPËTIM-MINIERAVE

	Kategoria	**Numri**
DREJTORIA E REPARTIT INSPEKTIM-SHPËTIM-MINIERA		
Titullar	II-b	1
DREJTORIA E INSPEKTIMIT		**17**
DREJTOR	III-a	1
SEKTORI I KONTROLLIT TEKNIK NË MINIERA		
Përgjegjës i sektorit të kontrollit teknik në miniera	III-a/I	1
Inspektor të kontrollit teknik në miniera, fabrika e pasurimit dhe impiantet e përpunimit të mineraleve	III-b	7
Inspektor të kontrollit teknik të përdorimit civil të lëndës plasëse	III-b	2
Inspektor të kontrollit teknik dhe matjes në miniera	III-b	1
SEKTORI I SIGURISË DHE I MBROJTJES SË SHËNDETIT		
Përgjegjës sektori, inspektor ajrimi e monitorimi	III-a/I	1
Inspektor i analizave dhe i konfortit të punës	III-b	2
Inspektor i transportit nëntokësor dhe impianteve energo-mekanike	III-b	2
DREJTORIA E EMERGJENCAVE DHE E SHPËTIMIT NË MINIERA		**16**
Drejtor	III-a	1
SEKTORI I EMERGJENCAVE NË MINIERA DHE KARRIERA		
Përgjegjës sektori i emergjencave dhe i shpëtimit në miniera	III-a/I	1
Inspektor i emergjencave në miniera dhe karriera	III-b	1
Teknik i mirëmbajtjes (kolaudimit) të pajisjeve të emergjencës (arsim i mesëm)		1
Teknik për emergjencat në miniera, shpëtues (arsim i mesëm)		5

SEKTORI I SHPËTIMIT NË MINIERA DHE KARRIERA		
Përgjegjës i skuadrës së shpëtimit në miniera dhe karriera	III-b	1
Teknik për shpëtim në miniera, shpëtues (arsim i mesëm)		5
Teknik i mirëmbajtjes, kolaudimit të pajisjeve shpëtuese (arsim i mesëm)		1
DREJTORIA EKONOMIKE, E SHËRBIMIT TË BRENDSHËM DHE E INFORMACIONIT		**13**
Drejtor	III-a	1
SEKTORI EKONOMIK DHE I SHËRBIMEVE TË BRENDSHME		
Përgjegjës sektori, specialist i ekonomisë	III-a/I	1
Magazinier dhe laborant (arsim i mesëm)		1
Sekretare e titullarit, arkivist dhe protokollist, përpunues dokumentacioni (arsim i mesëm)		1
Shofer i automjeteve të emergjencës (arsim i mesëm)		2
Teknik i mirëmbajtjes dhe i kolaudimit të automjeteve (arsim i mesëm)		1
Teknik i provave të litarëve të çelikut (arsim i mesëm)		1
Punonjëse sanitare (arsim i mesëm, tetëvjeçar)		1
SEKTORI I BURIMEVE NJERËZORE, I KOMUNIKIMIT DHE RUAJTJES SË INSTITUCIONIT		
Përgjegjës sektori	III-b	1
Teknik të mesëm për komunikimin dhe ruajtjen e institucionit		1
Teknik të mesëm për informacionin dhe ruajtjen e institucionit		2
Punonjës gjithsej		**47**

VENDIM
Nr. 109, datë 13.2.2013

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT "DOBRENJË-TOMORRICË" DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 3, e 23 pika 3 shkronja "b" të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 "Për koncesionet", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënien me koncesion, të formës "BOT" (ndërtim, operim dhe trasferim), të hidrocentralit "Dobrenjë-Tomorricë)", është Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënien me koncesion të këtij hidrocentrali, që i jepet shoqërisë "MGB" sh.p.k.

3. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Dobrenjë-Tomorricë", duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.

4. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 110, datë 13.2.2013

PËR MIRATIMIN E RIALOKIMIT TË FONDEVE SIPAS MARRËVESHJES SË HUAS DHE PROGRAMIT, NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E FINANCAVE, E FONDIT SHQIPTAR PËR ZHVILLIM DHE KFW FRANKFURT AM MAIN, PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT "FONDI I INVESTIMEVE SOCIALE IV"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës të nenit 26 të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë", si dhe të ligjit nr. 10 407, datë 31.3.2011 "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas dhe programit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave e Fondit Shqiptar për Zhvillim, si agjenci zbatimit të projektit, dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e projektit "Fondi i investimeve sociale IV"", me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e rialokimit të fondeve sipas marrëveshjes së huas dhe programit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Ministria e Financave e Fondit Shqiptar për Zhvillim dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit "Fondi i investimeve sociale IV", sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

FONDI I INVESTIMEVE SOCIALE IV: KOSTOJA TOTALE DHE FINANCIMI

SIF IV	Kostoja	Financimi		
Masat	**Kostoja për kategori në milionë euro**	**Huaja e bashkëpunimit financiar**	**Fondet e grandit IPA 2009**	**Kontributi lokal**
Komponenti i masave të rrugëve				
Rehabilitimi dhe ndërtimi i deri 100 km	19.500	11.500	8.000	
Plan projekti i detajuar dhe procedura mjedisore	0.400		0.400	
Mbikëqyrja	1.100	1.100		
Prokurimi dhe menaxhimi i kontratave *	0.200	0.200		
Kostoja e administrimit e FSHZH-së	0.900	0.300		0.600
Fond rezerve	2.300	1.900	0.400**	
Komponenti total i rrugëve	**24.400**	**15.000**	**8.800**	**0.600**
Komponenti i masave për ujin				
Ndërtimi i deri 20 - 25 ujësjellësve	4.100	3.500		0.600
Plan projekti i detajuar dhe konsulence e supervizimit te zbatimit (duke përfshirë mbështetjen institucionale)	1.067	1.067		
Kostot e administrimit të FSHZH-së	0.370	0.170		0.200
Fond rezerve	0.263	0.263		
Komponentët totalë të ujit	**5.800**	**5.000**		**0.800**
Komponenti i rrugës dhe ujit në SIF IV Total	**30.200**	**20.000**	**8.800**	**1.400**
Komponentët e trajnimit për të dy komponentët* **	**0.400**	**0.400**		
SIF IV totale, duke përfshirë trajnimin	**30.600**	**20.400**	**8.800**	**1.400**

*Duke supozuar se një kontratë për prokurimin dhe menaxhimin e kontratave do të nevojitej për një vit.
** Duke përfshirë financimin për auditimin e fondeve të IPA-s.
***Fondet e grantit për komponentin e trajnimit do të kërkohen veçmas.

VENDIM
Nr. 113, datë 13.2.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KONISPOL TË QARKUT TË VLORËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Konispol të qarkut të Vlorës, që transferohen në pronësi ose në përdorim të kësaj bashkie, sipas lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Lista me 65 (gjashtëdhjetë e pesë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 811 (tetëqind e njëmbëdhjetë).

2. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Konispol për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Konispol — Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
1 (vetëm pronën e bashkisë)	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve të administratës	Në pronësi
5-10	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e arsimit	Në pronësi
11, 12	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetit publik	Në pronësi
13-14	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive	Në pronësi
23-26	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shërbimit funeral	Në pronësi
27-71, 99-104, 362-364, 470-716	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi
105-108, 140-361	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji	Në përdorim
365-371	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e strehimit dhe të mbrojtjes civile	Në pronësi
469	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve	Në pronësi

VENDIM
Nr. 114, datë 13.2.2013

PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË MAMURRAS TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisje vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave paluajtshme publike shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim, të bashkisë Mamurras të qarkut të Lezhës, sipas lidhjes nr. 1, e cila i bashkëlidhet këtij vendimi është pjesë përbërëse e tij.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj bashkie, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të bashkisë Mamurras të qarkut të Lezhës, miratuar me vendimin nr. 67, datë 21.1.2009 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në bashkinë Mamurras të qarkut të Lezhës".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe bashkia Mamurras për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Mamurras — Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
101-112	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore	Në pronësi
113-120	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e shëndetësisë	Në pronësi
121-131, 148, 154, 157, 164, 165, 170, 173	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka joproduktive dhe kanale të treta)	Në pronësi
140-147	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive). Nuk transferohet sipërfaqja 185.6 ha trajtuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 868, datë 18.6.2008	Në përdorim

VENDIM
Nr. 115, datë 13.2.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 167, DATË 10.3.2010 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË KUKËS TË QARKUT TË KUKËSIT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3, 5 e 17 të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001 "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në listën përfundimtare, që i bashkëlidhet vendimit nr. 167, datë 10.3.2010 të Këshillit të Ministrave, për të dhënat për pronat me numrat rendorë 945-952 (nëntëqind e dyzet e pesë deri në nëntëqind e pesëdhjetë e dy), gjithsej 1 (një) fletë, sipas formularit dhe lidhjes nr. 1, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të bashkisë Kukës të qarkut të Kukësit, shtohen pronat me numrat rendorë 966-988 (nëntëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë deri në nëntëqind e tetëdhjetë e tretë), gjithsej 3 (tre) fletë, sipas lidhjes nr. 1 dhe formularëve, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe bashkia Kukës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Bashkia Kukës — Lidhja nr. 1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	**Fusha e përdorimit të pronës**	**Lloji i transferimit**
945-952, 966-988	Infrastrukturë (sheshe)	Në pronësi

VENDIM
Nr. 116, datë 13.2.2013

PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË DISA MJEDISEVE, MAGAZINË, GARAZH DHE LAVANTERI E INFEKTIVIT, NË SPITALIN RAJONAL ELBASAN, NGA MINISTRIA E SHËNDETËSISË TE MINISTRIA E ARSIMIT DHE SHKENCËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja "c" të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë dhe të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të mjediseve të Spitalit Rajonal Elbasan, nga Ministria e Shëndetësisë te Ministria e Arsimit dhe Shkencës, për t'u përdorur nga universiteti "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi, si më poshtë vijon:

- Magazinë (ish-zdrukthtaria) sip. 132.7 m^2, zona kadastrale 7/27;
- Garazhi i autoambulancave sip. 75.2 m^2, zona kadastrale 7/21;
- Lavanteri e infektivit sip. 120.0 m^2, zona kadastrale 7/21.

(e papërdorshme)

2. Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan, i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në këtë vendim, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

3. Ngarkohen Ministri i Shëndetësisë, Ministri i Arsimit dhe Shkencës dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë të ndjekin procedurat e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

PLANVENDOSJE: SH 1:500

OBJEKTET E Q.S. XH. KONGOLI ELBASAN

(ANA PERENDIMORE)



LEGJENDA:

1. KABINE ELEKTRIKE
2. MAGAZINE (ISH ZDRUKTHTARIA)
3. GARAZH PER AUTO ABMULANCAT
4. LAVANDERI E INFEKTIVIT (E PAPERDORSHME)

TIRANE 2010	ND. ND. PROJEKTIMIT "BILALI" sh.p.k.	
	PLANVENDOSJE sh 1:500	
BILALI sh.p.k	ARKITEKT	Dervish BILALI
	URBANIST	Dorjan KUSHI
	INXHINIER	Anxelina KUQI
	H / SANITAR	

VENDIM
Nr. 118, datë 13.2.2013

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 109, DATË 15.2.2012 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E BRENDSHME DHE TE MINISTRIA E PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT, PËR DREJTORINË RRUGORE SHKODËR, TË DISA OBJEKTEVE E TË TRUALLIT FUNKSIONAL, PJESË TË PRONËS NR. 426, ME EMËRTIM "SHTABI I BRIGADËS SË ARTILERISË", ME VENDNDODHJEN NË RRENC, SHKODËR, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 1 të vendimit nr. 109, datë 15.2.2012 të Këshillit të Ministrave, fjalët "… sipërfaqe të përgjithshme 28 170.3 (njëzet e tetë mijë e njëqind e shtatëdhjetë pikë tre) m^2, pjesë e pronës nr. 426, me emërtim "Shtabi i Brigadës së Artilerisë", me vendndodhje në Rrenc, Shkodër, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi …", zëvendësohen me fjalët "… sipërfaqe të përgjithshme 31 165.2 (tridhjetë e një mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë pikë dy) m^2, pjesë e pronës nr. 426, me emërtim "Shtabi i Brigadës së Artilerisë", me vendndodhje në Rrenc, Shkodër, sipas planvendosjes bashkëlidhur këtij vendimi …".

2. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Brendshëm dhe Kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha


MIRATOHET
KOMANDANTI I BRIGADES LOGJISTIKE
KOL. BARIKOLA
PLAN VENDOSJA E ISH REP.USHT. NR. 1190
(PRONA NR.426)
RENCË SHKODER
S2
SHPJEGUESE
KUFIRI I REPARTIT
Shenim
SHKALLA 1 : 2500
PERGJ.I DEP. TEGJEOMATIKES
DREJTOR

FORMULARI PER INVENTARIZIMIN E PRONES NR.426, RENC, SHKODER (Siperfaqja qe I ngelet Rep.Usht.Nr.4303)

(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te vecanta)

Ministria e Mbrojtjes		**Identifikoi:**	Specialisti I Infrastruktures N/Toger Florenc BARDHI
Brigada Logjistike			
Reparti Ushtarak Nr. 4303		**Supervizoi:**	Shefi Operacional, N/Kolonel Idriz KUCA Shefi i logjistikes, Major Hashim SERANI Shefi i finances Kapiten Tefik KAMBO
Pezë-Helmës Tirane		**Aprovoi:**	Zv/Komandant I Repartit Ushtarak Nr 4303
Fusha e perdorimit te prones: Per mbrojtjen			N/Kolonel Rexhep KORTOÇI

Nr I Prones	Zona Kadastrale, Indeksi I Hartes	Nr. I pasuris e	Emertesa e prones, Vendndodhja, Shtrirja Gjeografike	Sipas VKM Nr. 109, DT.15.02.2012		Adresa , vendndodhja e komponenteve perberes	Funksioni per te cilin perdoret prona	Enti me pergjegjesi administrati ve	Enti perdorues Statusi juridik I perdorimit	Te dhena te tjera, shenime te vecanta
				Komponentet perberes te prones	Permasat e prones ne m2 ose ml					
1	2	3	4	7	8	9	10	11	12	13
426	**3168, K-34-64**		**Renc, Shkoder**		**2994.9 m2**	**Renc, Shkoder**	Per Mbrojtjen	Rep.Usht.Nr.4300	Rep.Usht.Nr.4303	
S3/1					**451.3 m2**					
S3/2					**1014.3 m2**					
S3/3					**1528.7 m2**					

Shenim: Sipas VKM, Nr.109, date 15.02.2012, Siperfaqja prej 28170.3 m2, se bashku me Objektet Nr.1,3,4,6,8,10,11,12,13,14, ju dorzua Ministrise se Brendeshme, ndersa siperfaqja prej 2381.8 m2 se bashku me Objektet Nr.2,5,7, ju dorzua Drejtorise Rrugore Shkoder. Sierfaqja qe i ngelet Rep.Usht.Nr.4303, eshte 2994.9 m2.

KËRKESË
Nr. 293/7, datë 15.2.2013

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike dhe Transportit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Elbasan (toka dhe objekte).

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkojmë të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar (sipërfaqet m^2), si dhe në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 138, datë 23.3.2000 (objektet), për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i afatit të publikimit, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit).

Lidhur me pasuritë truall, të cilat janë publikuar në periudhën dhjetor 2011 - janar 2012, sqarojmë se po ripublikohen për efekt të çmimit, pasi ka pasur një gabim në referencën bërë në atë kohë, për sa i përket çmimit për pasurinë truall. Në këtë publikim është vënë çmimi i saktë referuar kuadrit ligjor.

Pasuritë, për të cilat është bërë shënimi në kolonën përkatëse "Rikonfirmim", sqarojmë se nga konfirmimet e dhëna nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ka paqartësi apo mangësi të dhënash ose për këto pasuri nuk është dhënë ende konfirmim nga kjo zyrë. Për këto pasuri do të rimerret konfirmim pranë ZVRPP-ve, Tiranë dhe Elbasan dhe në bazë të konfirmimeve që do të jepen nga këto zyra do të hartohen dhe listat përfundimtare, të cilat do të propozohen për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Për pasuritë, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi "E paregjistruar", me pronarë të paidentifikuar, personat të cilët pretendojnë pronësinë, duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre, në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi. Lidhur me objektet, sqarojmë se jemi në pritje të konfirmimit nga ALUIZNI. Në bazë të konfirmimit që do të jepet nga ky institucion, do të hartohen dhe listat përfundimtare, të cilat do të propozohen për miratim pranë Këshillit të Ministrave.

Për pasuritë, për të cilat është bërë shënimi "Proces regjistrimi", sqarojmë se pronarët do të kompensohen pas përfundimit të këtij procesi dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë.

Për objektet, për të cilat është bërë shënimi "Pa dokumentacion/i pakonfirmuar", sqarojmë se personat që pretendojnë pronësinë, duhet të aplikojnë për regjistrimin e tyre ose të paraqesin dokumentacionin tekniko-ligjor pranë MPPT-së, në të kundërt nuk do të kompensohen për efekt shpronësimi.

Për pasuritë, për të cilat është bërë shënimi "Konfirmuar nga ZVRPP-ja", sqarojmë se pronarët përkatës do të kompensohen për efekt shpronësimi pas daljes së vendimit të Këshillit të Ministrave dhe në bazë të dokumentacionit të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

Vlera totale e këtij shpronësimi është 81 917 933.86 (tetëdhjetë e një milion e nëntëqind e shtatëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e tri pikë tetëdhjetë e gjashtë) lekë.

MINISTRI I PUNËVE PUBLIKE DHE TRANSPORTIT
Sokol Olldashi

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI TOPOLOGJIK

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE SEGMENTIT RRUGOR TIRANE - ELBASAN

Nr.	Nr.Pas.	Emri-Atesia-Mbiemri	ZK	Vlera Leke	Lloji I objektit	Shenime
1	218/29	Ilirjan Panariti	2735	966,244	Mur rrethues	Leje ndertimi
2	44/13	Genc Drita	1977	1,042,820	Banese 1 kt	Konfirmuar nga ZVRPP
3	45/20	Aneta Alimemaj	1170	282,607	Mur rrethues	Leje ndertimi
4	353	I Paidentifikuar	1170	1,181,028	Zyra&Magazine (nyje prodhim inerte)	Pa dokumentacion/I pakonfirmuar
5	353	I Paidentifikuar	1170	659,532	Zyra&Magazine (nyje prodhim inerte)	Pa dokumentacion/I pakonfirmuar
		TOTALI		**4,132,230**		

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI TOPOLOGJIK

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE SEGMENTIT RRUGOR TIRANE - ELBASAN
PER PUBLIKIM

Nr.	PRONARI	NR. PAS	ZK	TOKE ARE			TOKE TRUALL			VLERA TOTALE (LEKE)	Shenime
	Emri - Atesia - Mbiemri			SIP (M2)	CMIMI (LEK/ M2)	Vlera(leke)	SIP (M2)	CMIMI (LEK/M 2)	Vlera(leke)		
	Fshati Berzhite Z.K.1170										
1	Skender Skalaj	222/38	1170	620	322	199640				199640	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Agim Gjuzi	222/37	1170	1565	322	503930				503930	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Murat Gjuzi	222/36	1170	2270	322	730940				730940	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Ramazan Gjuzi	222/35	1170	4101	322	1320522				1320522	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Muharrem Fili	222/34	1170	2310	322	743820				743820	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Xhavit Sallaku	222/33	1170	3990	322	1284780				1284780	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Xhavit Sallaku	222/58	1170	2505	322	806610				806610	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Ilir Baron Hoxha	222/50	1170	800	322	257600				257600	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Ilir Baron Hoxha	222/47	1170	225	322	72450				72450	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Ilir Baron Hoxha	222/40	1170		322		1140	1919.2	2187888	2187888	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Selim Basha	222/57	1170	790	322	254380				254380	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Xhemal Sinan Sallaku	222/27	1170	1402	322	451444				451444	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Haxhi Haxhi Sallaku	222/49	1170		322		1088	1919.2	2088089.6	2088089.6	Rikonfirmim
14	Ramazan Gjuzi	126/109	1170	1245	322	400890				400890	Konfirmuar nga ZVRPP
15	Ramazan Gjuzi	126/111	1170	1433	322	461426				461426	Konfirmuar nga ZVRPP
16	Rukije Stafa	126/103	1170	815	322	262430				262430	Konfirmuar nga ZVRPP
17	Hajdar Gjuzi	126/99	1170	1043	322	335846				335846	Konfirmuar nga ZVRPP
18	Xhavit Shaba	126/39	1170	165	322	53130				53130	Konfirmuar nga ZVRPP
19	Xhavit Shaba	126/36	1170	260	322	83720				83720	Konfirmuar nga ZVRPP
20	I Paidentifikuar	71/13	1170	365	322	117530				117530	Rikonfirmim
21	Trashg. Ramazan Asllani	71/14	1170	535	322	172270				172270	Rikonfirmim
22	Jemin Muja	71/15	1170	413	322	132986				132986	Konfirmuar nga ZVRPP
23	Kasem Asllani	45/13	1170	1074	322	345828				345828	Konfirmuar nga ZVRPP
24	Sabri Hamza Tarja	42/1	1170	1285	322	413770				413770	Konfirmuar nga ZVRPP
	TOTALI			**29211**		**9405942**	**2228**		**4275977.6**	**13681919.6**	

QENDRA E BOTIMEVE ZYRTARE QBZ

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI TOPOLOGJIK

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE SEGMENTIT RRUGOR TIRANE - ELBASAN PER PUBLIKIM

Nr.	PRONARI	NR. PAS	ZK	TOKE ARE			Shenime
	Emri - Atesia - Mbiemri			SIP (M2)	CMIMI (LEK/M2)	Vlera(leke)	
	Fshati Dobresh						
1	Bajram Mali	426/18	1498	1947	323	628881	Rikonfirmim
	TOTALI			**1947**		**628881**	

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI TOPOLOGJIK

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE SEGMENTIT RRUGOR TIRANE - ELBASAN PER PUBLIKIM

Nr.	PRONARI	NR. PAS	ZK	TOKE ARE			TOKE TRUALL			VLERA TOTALE (LEKE)	Shenime
	Emri - Atesia - Mbiemri			SIP (M2)	CMIMI (LEK/M2)	Vlera(leke)	SIP (M2)	CMIMI (LEK/M2)	Vlera(leke)		
	Fshati Fikas Z.K.1622										
1	Bashkepronare Beka	23/29	1622	760	1622	1232720				1232720	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Haziz Ramazan Kerciku	23/26	1622	327	1622	530394				530394	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Federata e Familjes per	23/16	1622				84	1919.2	161212.8	161212.8	Rikonfirmim
	Paqe Boterore dhe Bashkim										
	TOTALI			**1087**		**1763114**	**84**		**161212.8**	**1924326.8**	

QENDRA E BOÏTIMEVE ZYRTARE QBZ

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI TOPOLOGJIK

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE SEGMENTIT RRUGOR TIRANE - ELBASAN
PER PUBLIKIM

Nr.	PRONARI	NR. PAS	ZK	TOKE ARE			TOKE TRUALL			VLERA TOTALE (LEKE)	Shenime
	Emri - Atesia - Mbiemri			SIP (M2)	CMIMI (LEK/M2)	Vlera(leke)	SIP (M2)	CMIMI (LEK/M2)	Vlera(leke)		
	Fshati Ibe e Poshtme										
1	Nexhip Çoku	31/1	1977	500	258	129000				129000	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Besim Çoku	31/2	1977	800	258	206400				206400	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Qani Bana	301/2	1977	717	258	184986				184986	Konfirmuar nga ZVRPP
4	Besim Çoku	301/11	1977	1460	258	376680				376680	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Petrit Çoku	300	1977	650	258	167700				167700	Konfirmuar nga ZVRPP
6	Petrit Çoku	30	1977	518	258	133644				133644	Konfirmuar nga ZVRPP
7	Petrit Çoku	301/13	1977	288	258	74304				74304	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Besim Çoku	47/3	1977	25	258	6450				6450	Rikonfirmim
9	Besim Çoku	47/4	1977	400	258	103200				103200	Rikonfirmim
10	Emin Kukli	120/1	1977	700	258	180600				180600	Konfirmuar nga ZVRPP
11	Emin Kukli	122/1	1977	1650	258	425700				425700	Konfirmuar nga ZVRPP
12	Ramazan Proga	44/37	1977	1120	258	288960				288960	Konfirmuar nga ZVRPP
13	Islam Banaj	301/2	1977				74	1919.2	142020.8	142020.8	Konfirmuar nga ZVRPP
14	Genc Drita	44/13	1977				2338	1919.2	4487089.6	4487089.6	Konfirmuar nga ZVRPP
	TOTALI			**8828**		**2277624**				**6906734.4**	

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI TOPOLOGJIK

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE SEGMENTIT RRUGOR TIRANE - ELBASAN

Nr.	PRONARI Emri - Atesia - Mbiemri	NR. PAS	ZK	SIP (M2)	CMIMI (LEK/M2)	Vlera(leke)	Shenime
	Fshati Lunder Z.K.2529						
1	Llazam Doda	583/21	2529	788	2622.165	2066266.02	Rikonfirmim
2	Refit Korbeci	583/17	2529	1590	2622.165	4169242.35	Konfirmim ZVRPP
3	Pellumb & Ismet Krraba	583/28	2529	120	2622.165	314659.8	Konfirmim ZVRPP
	TOTALI			**2498**		**6550168.17**	

QENDRA E BOTIMEVE ZYRTARE QBZ

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI TOPOLOGJIK

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE SEGMENTIT RRUGOR TIRANE - ELBASAN PER PUBLIKIM

Nr.	PRONARI Emri - Atesia - Mbiemri	NR. PAS	ZK	SIP (M2)	CMIMI (LEK/M2)	Vlera(leke)	Shenime
	Fshati Mjull Bathore Z.K.2704						
1	Latif Begu	242/21	2704	1430	2622.165	3749695.95	Konfirmuar nga ZVRPP
2	Bilal Begu	255/15	2704	825	2622.165	2163286.125	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Alush Isuf Tujani	258/8	2704	178	2622.165	466745.37	Proces regjistrimi
4	Hamdi Isuf Tujani	258/9	2704	161	2622.165	422168.565	Konfirmuar nga ZVRPP
5	Bashkim Ramiz Tujani	303/6	2704	1306	2622.165	3424547.49	Konfirmuar nga ZVRPP
6	I Paidentifikuar	304/6	2704	930	2622.165	2438613.45	Rikonfirmim
7	Skender Tujani	304/3	2704	400	2622.165	1048866	Konfirmuar nga ZVRPP
8	Ramiz Tujani	304/2	2704	1992	2622.165	5223352.68	Konfirmuar nga ZVRPP
9	Haxhi Gjuzi	307/26	2704	340	2622.165	891536.1	Konfirmuar nga ZVRPP
10	Haxhi Gjuzi	307/25	2704	2050	2622.165	5375438.25	Konfirmuar nga ZVRPP
11	I Paidentifikuar	306/19	2704	600	2622.165	1573299	E paregjistruar
12	I Paidentifikuar	203/4	2704	75	2622.165	196662.375	E paregjistruar
13	Ismet Ibrahim Dushku	269/6	2704	1850	2622.165	4851005.25	Konfirmuar nga ZVRPP
	TOTALI			**12137**		**31825216.61**	

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI TOPOLOGJIK

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE SEGMENTIT RRUGOR TIRANE - ELBASAN

Nr.	PRONARI	NR. PAS	ZK	TOKE ARE			TOKE TRUALL			VLERA TOTALE (LEKE)	Shenime
	Emri - Atesia - Mbiemri			SIP (M2)	CMIMI (LEK/M 2)	Vlera(leke)	SIP (M2)	CMIMI (LEK/M 2)	Vlera(leke)		
	Fshati Mullet Z.K.2735										
1	Bashkepronaret Kukli	22/17	2735	2791	233	650303				650303	Kofirmim ZVRPP
2	Petrit Burnaca	22/12	2735	3495	233	814335				814335	Kofirmim ZVRPP
3	Ismail Celiku	22/10	2735	856	233	199448				199448	Kofirmim ZVRPP
4	Ibrahim Allmuca	22/6/2	2735	2230	233	519590				519590	Kofirmim ZVRPP
5	Bashkepronaret Kukli	22/6/8	2735	1140	233	265620				265620	Kofirmim ZVRPP
6	Osman Celiku	22/14	2735	2940	233	685020				685020	Kofirmim ZVRPP
7	Haki Said Teqja	125/12	2735	1080	233	251640				251640	Kofirmim ZVRPP
8	Vasil Jorgaqi	218/39	2735				1608	1919.2	3086073.6	3086073.6	Kofirmim ZVRPP
9	Ramazan Haxhiu	212/6	2735	2300	233	535900				535900	Rikonfirmim
10	Ramazan Haxhiu	217/54	2735	189	233	44037				44037	Rikonfirmim
11	Ramazan Haxhiu	217/52	2735	38	233	8854				8854	Rikonfirmim
12	Hysni Haxhiu	211/1/1	2735				260	1919.2	498992	498992	Kofirmim ZVRPP
13	Hiqmet Sinakolli	215/5	2735				209	1919.2	401112.8	401112.8	Kofirmim ZVRPP
14	Shqipe Jahja	215/2	2735				72	1919.2	138182.4	138182.4	Kofirmim ZVRPP
	TOTALI			**17059**		**3974747**	**2149**		**4124360.8**	**8099107.8**	

QENDRA E BOTIMEVE ZYRTARE QBZ

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI TOPOLOGJIK

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE SEGMENTIT RRUGOR TIRANE - ELBASAN
PER PUBLIKIM

Nr.	PRONARI	NR. PAS	ZK	TOKE ARE			VLERA	Shenime
	Emri - Atesia - Mbiemri			SIP (M2)	CMIMI (LEK/M2)	Vlera(leke)	TOTALE (LEKE)	
	Fshati Mushqeta							
1	Fadil Velia	57/3	2752	95	254	24130	24130	Proces regjistrimi
2	Hysen Velia	57/4	2752	70	254	17780	17780	Proces regjistrimi
3	Riza Tafa	55	2752	364	254	92456	92456	Proces regjistrimi
4	Osman Tafa	54	2752	564	254	143256	143256	Rikonfirmim
	TOTALI			**1093**		**277622**	**277622**	

AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI TOPOLOGJIK

LISTA E PRONAREVE QE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE NDERTIMIT TE SEGMENTIT RRUGOR TIRANE - ELBASAN
PER PUBLIKIM

Nr.	PRONARI Emri - Atesia - Mbiemri	NR. PAS	ZK	SIP (M2)	CMIMI (LEK/M2)	Vlera(leke)	Shenime
	Fshati Sauk Z.K.3266						
1	Agim Isuf Greblleshi	162/8	3266	295	2622.165	773538.675	Konfirmim ZVRPP
2	Fatime Isuf Qela	162/10	3266	350	2622.165	917757.75	Konfirmim ZVRPP
3	Ismete Isuf Bendi	170/1	3266	710	2622.165	1861737.15	Konfirmim ZVRPP
4	I paidentifikuar	170/2	3266	580	2622.165	1520855.7	Rikonfirmim
5	Ikbale Isuf Goni	162/9	3266	1110	2622.165	2910603.15	Konfirmim ZVRPP
6	Fatmir Brahja	168/49	3266	1730	2622.165	4536345.45	Konfirmim ZVRPP
	TOTALI			**4775**		**12520837.88**	

QENDRA E BOJTIMEVE ZYRTARE QBZ

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Elbasan, me vendimin nr. 194, datë 28.1.2013, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetases Eda Hasani, e bija e Eminit dhe e Antonetës, e datëlindjes 9.9.1959.

KËRKESË

Shtetasja Nimete Balliu, e datëlindjes 15.4.1954, lindur në Rovicë dhe banuese në Tiranë, kërkon, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë shpalljen të vdekur të vajzës së saj, shtetases Elida Balliu.

KËRKUESE
Nimete Balliu

KËRKESË

Shtetasi Hasan Klari, i biri i Sherifit dhe i Sherifes, i datëlindjes 7.3.1967, lindur në Shijak dhe banues Borakë-Xhafzotaj, Durrës, kërkon pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, shpalljen të zhdukur të vëllait të tij, shtetasit Haki Klari.

KËRKUES
Hasan Klari

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 007.

Hyri në shtyp më 4.3.2013
Doli nga shtypi më 4.3.2013

	Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2013

Çmimi 34 lekë